



PARIMET ETIKE  
DHE PROFESIONALE  
TË RTM-së  
PËR MBULIMIN  
MEDIAL TË  
PROCESEVE  
ZGJEDHORE

**MPT**

**PARIMET ETIKE DHE PROFESIONALE TË RTM-së  
PËR MBULIMIN MEDIAL TË PROCESIVE  
ZGJEDHORE**





**British Embassy  
Shkopje**

Ambasada Britanike në Shkup mbështeti përgatitjen e këtij publikimi, brenda projektit *"Paanshmëria dhe pavarësia e mediave si parakusht për proces zgjedhor të lirë dhe fer"*. Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike në Shkup.

<b>HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>I. PARIME PËR MBULIMIN E PROCESEVE ZGJEDHORE</b>	<b>7</b>
1. Balancim dhe paanshmëri	7
2. Barabarësi gjatë paraqitjes së kandidatëve	12
3. Saktësi dhe kontrollim të informacioneve	14
4. Informacionet duhet të jenë precize dhe në kontekst	16
5. Ndarja mes fakteve dhe mendimeve	18
6. Roli i dyfishtë i pushtetit në periudhën zgjedhore	19
7. Gjuha e urrejtjes dhe gjuha “ndezeëse”	20
8. Informimi për hulumtimin e mendimit publik	21
9. Heshtja zgjedhore	23
10. E drejta e korrigjimit dhe e përgjigjes	23
<b>II. PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE DHE INTEGRITETI PERSONAL I GAZETARËVE</b>	<b>25</b>
1. Përgjegjësia shoqërore e gazetarëve	25
2. Integriteti dhe ndershmëria profesionale e gazetarëve	26
3. Përdorimi personal i mediave sociale	28
<b>III. KONTRIBUTI NGA PUBLIKU DHE PJESËMARRËSIT NË ZGJEDHJE</b>	<b>29</b>
1. Materiale nga publiku	29
2. Materiale nga partitë ose nga kandidatët	30
Literatura e shfrytëzuar	34



## HYRJE

Përkushtimi i RTM-së në sigurimin e raportimit të paanshëm dhe të drejtë, si dhe përgjithësisht në ruajtjen e standardeve etike dhe profesionale, është nën thjerrën e opinionit publik sidomos gjatë kohës së zgjedhjeve.

Qëllimi i *Parimeve etike dhe profesionale të RTM-së për mbulimin medial të proceseve zgjedhore* është që të sigurojë kornizën në të cilën gazetarët lirisht dhe pa u penguar të mund të punojnë dhe t'i ofrojnë publikut informim të paanshëm dhe të pavarur për procesin zgjedhor, përmes raportimit fer dhe trajtimit analitik të kandidatëve të programeve partiake dhe të fushatave.

*Parimet* janë në pajtim me standardet ndërkombëtare, si dhe me:

- Standardet dhe rregullat të cilave duhet t'u përmbahet servisi radiodifuziv publik RTM dhe gazetarët, redaktorët dhe punonjësit tjerë në RTM-së gjatë prodhimit dhe sigurimit të programeve të radios dhe të televizionit, të përcaktuara në Ligjin për shërbime mediale audio dhe audiovizive;

- Obligimet që RTM të sigurojë mbulim të drejtë, të balancuar dhe të paanshëm të zgjedhjeve në tërë programin e vet, të përcaktuara në Kodin zgjedhor;
- Kodin e gazetarëve të Republikës së Maqedonisë; dhe
- Rregullat etike dhe standardet e RTM-së.

RTM do t'i aplikojë këto parime etike dhe profesionale që nga shpallja e zgjedhjeve deri në përfundim të tyre.

Parimet janë me qasje publike, të shpallura në vend të dukshëm në ueb-faqen e RTM-së dhe RTM do të jetë përgjegjëse për zbatimin e tyre.

# I.

## PARIME PËR MBULIMIN E PROCESHEVE ZGJEDHORE

### 1. Balancim dhe paanshmëri

Servisi radiodifuziv publik ka obligim që të jetë **i balancuar dhe i paanshëm** në raportimin për zgjedhjet dhe të mos diskriminojë asnjë parti politike, koalicion a kandidat të pavarur.

*Vetëm përmes shprehjes së mendimeve të ndryshme në mënyrë të drejtë dhe të saktë, edhe atë për të gjitha çështjet e rëndësishme, RTM obligohet se do ta paraqet pamjen e vërtetë për ndodhitë dhe temat që do t'i përpuñojë. Kjo nënkupton:*

- Të reflektojë spektrin e gjerë të mendimeve
- T'i hulumtojë pikëpamjet e kundërshtuara
- Të mbajë llogari që mos të injorohet asnjë perspektivë relevante (në pikëpamje të përkatësisë etnike dhe gjinore, të preferencës politike, të moshës, të prejardhjes sociale, të personave me nevoja të veçanta, të atyre me pengesa shqisore e të ngjashme)

- Të shmangët çfarëdo lloj bindje personale paraprake në lidhje me temën për të cilën do të raportohet ose për zgjedhjen e njerëzve që do të intervistohen
- Të demonstrojë sinqeritet dhe transparencë në lidhje me çfarëdo lloj interesash/përkatësish personale.

**Balancimi** do të thotë që lajmet, intervistat, debatet dhe programet tjera informative nuk guxojnë të jenë as në favor, as kundër cilësdo parti, koalicion a kandidat. Balancimi duhet të arrihet edhe në kuptimin kualitativ edhe në kuptimin kuantitativ. Gazetari patjetër të raportojë për programet partiake dhe për debatet midis partive ose kandidatëve ashtu që qytetarëve do t'u mundësojë që ta bëjnë krahasimin. Gazetarët profesionalë i janë të përkushtuar kërkimit të fakteve dhe raportimit për to në mënyrë objektive. Gazetari mund të shtrojë pyetje, të paraqesë pikëpamje të ndryshme dhe të ofrojë informacione bazë dhe kontekst, por gjithnjë duhet të mbajë llogari për balancimin dhe neutralitetin.

Plus kësaj, çdo ditë, emision, si dhe faqe e internetit, duhet të mundësojë mbulimin përkatës të të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, përfshi edhe partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur. Në periudhën që nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën e fillimit të fushatës RTM do të sigurojë mbulim proporcional dhe adekuat të subjekteve politike në procesin zgjedhor në nivel javor, ndërsa gjatë fushatës zgjedhore do të vlejnjë Rregullat për mbulim medial të proceseve zgjedhore, të cilat RTM i miratoi si obligim nga Kodi zgjedhor.

**Paanshmëria** shpesh do të thotë më shumë se sa arritja e balancimit ndërmjet pikëpamjeve të ndryshme. Paanshmëria do të thotë se në raportim nuk ka paragjykime ndaj, ose kundër, cilësdo palë. Ky parim nënkupton inklusivitetin në raportim - të shihet perspektiva më e gjerë dhe të sigurohet se pikëpamjet e ndryshme që ekzistojnë janë transmetuar në mënyrë adekuate. Të gjithë gazetarët kanë mendimet

e tyre personale dhe, që të mundësojnë mbulimin gjithëpërfshirës dhe profesional të lajmeve dhe të ngjarjeve në vazhdim, ata duhet të ngrihen mbi pikëpamjet e tyre personale.

Obligimi për informim të elektoratit dhe për raportim në mënyrë të balancuar dhe të paanshme ka të bëjë me të gjitha emisionet, e sidomos me lajmet. RTM në lajme do të raportojë për informacionet që mbështeten në faktet e kontrolluara dhe të vërtetuara.

Po qe se ka lajme të tjera të rëndësishme, të cilat drejtpërdrejt nuk janë të lidhura me zgjedhjet, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë asaj se çdo subjekt politik është mbuluar në mënyrë adekuate, me ç'rast do të theksohet edhe fakti se shteti është në periudhë zgjedhore. Mënyra se si do të arrihet kjo, do të varet nga rrethanat konkrete, karakteristike për atë rast. Për shembull, në rastet kur ka storje kryesore që nuk janë të lidhura me rivalitetin ndërpartiak, paanshmëria mund të arrihet duke ndarë më shumë kohë për ata politikanë të cilët më shumë janë të përfshirë. Me këtë rast, deklaratat e tyre do të ishin transmetuar në tërësi, duke i siguruar kështu opinionit publik faktet dhe, sipas nevojës do të ishin paraqitur debatet energjike interne në kuadër të partive.

Në rrethana të jashtëzakonshme, komentet nga politikanët mund të paraqiten edhe ndaras, pa kurrfarë sfondi politik (intervista që lidhen me fatkeqësi, me tragjedi personale, kur politikanë është dëshmitar okular i ndonjë incidenti). Çdo propozim për shfrytëzimin e komenteve në këtë mënyrë patjetër të jetë i lejuar nga redaktori.

**Raportimi në mënyrë të balancuar dhe të paanshme nënkupton:**

- Gazetari nuk guxon të lejojë që mendimet e tij/të saj të hetohen, drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte, përmes mënyrës së raportimit, sesi flet, ose sipas sjelljes së tij/të saj.
- Me shumë rëndësi është të raportohet në mënyrë korrekte. Citatat prej kandidatëve dhe liderëve të partive gjithnjë duhet të transmetohen pa ndryshime dhe në kontekstin gjegjës. Nëse gazetari nuk është i sigurt se për çfarë bëhet fjalë, ai gjithnjë mund të kontaktojë, përsëri, me personin dhe të kërkojë qartësim.
- Kur ka nevojë për përkthim (nëse kandidati flet në gjuhën e bashkësisë jo shumicë), duhet pasur shumë kujdes që mos të rrotullohet kuptimi i asaj çfarë është thënë. Në këtë kontekst, redaktori do të vendosë se a do të përdoret përkthimi ose dublimi zanor.
- Tregimi gazetaresk asnjëherë nuk guxon të shfrytëzohet për mbështetjen e partisë ose të kandidatit.
- Toni i raportimit në lajme/tregimet gazetareske patjetër duhet të jetë neutral. Ata (gazetarët) duhet të informojnë për dallimet ndërmjet palëve, pa dhënë me këtë rast mendim ose gjykim për to, në çfarëdo qoftë mënyre.
- Tregimi gazetaresk asnjëherë nuk guxon të shfrytëzohet për paraqitjen e pikëpamjeve personale. Gazetari e ka obligim profesional që mos të nxjerrë qëndrime personale për temën e lajmit. Pikëpamjet e gazetarit në lidhje me një çështje të caktuar asnjëherë nuk guxojnë të bëhen pjesë e tregimit, as të përmenden në çfarëdo qoftë mënyre.
- Gazetari asnjëherë nuk guxon të mbajë petka, shenja, etiketa ose çfarëdo lloj sendesh të tjera me inicialet ose slogane të cilat asociojnë në parti ose kandidat të caktuar.

- Gazetari duhet të përmbahet nga shprehja e çfarëdo lloj mendimi për parti të ose kandidatin gjatë kohës së mitingjeve, gjatë raportimit nga vendi i ngjarjes ose përmes intervistave.
- Në lajme duhet pasur kujdes renditjen e informacioneve për subjektet politike. Kontributet për parti të nga pushteti dhe nga opozita duhet t'i nënshtrohen rotacionit.

## 2. Barabarësi gjatë paraqitjes së kandidatëve

Të gjitha partive dhe kandidatëve që marrin pjesë në zgjedhje duhet t'u sigurohet **qasje e barabartë në media**. Ky është parimi themelor për zhvillimin e zgjedhjeve të lira, fer dhe transparente. Qëllimi është që të nxitet debat i gjallë dhe t'u jepet më shumë hapësirë dhe shikim kandidatëve, pa i dhënë me këtë rast përparësi asnjërit kandidat a parti në llogari të tjetrit.

### *Barabarësia mund të sigurohet në mënyrën vijuese:*

- ➔ Po qe se ndonjë kandidat merr pjesë në ndonjë kontribut/emision për ndonjë zonë të caktuar zgjedhore, atëherë edhe kandidatëve të tjerë, gjithashtu, duhet t'u jepet mundësia e pjesëmarrjes, ose t'u jepet mundësia e ngjashme në serinë e raportimeve. Kandidatëve ose partive që nuk kanë treguar se kanë mbështetje të theksuar nga zgjedhësit në atë zonë, megjithatë, duhet t'u sigurohet mbulimi proporcional.
- ➔ Serviset programore të RTM-së mund të vendosin se a do të ftojnë kandidat ose përfaqësues të partive mysafir në emisione të ndryshme (lajme, debate, intervista, programe informative politike). Megjithatë, po qe se është ftuar kandidati i zgjedhjeve nga një parti, atëherë, nëse ka mundësi, edhe pjesëmarrësit tjerë duhet të jenë kandidatë partiakë. Në situata të jashtëzakonshme, po qe se deri te kandidati nuk mund të arrihet, mundësia për të qenë mysafir mund t'i ofrohet përfaqësuesit adekuat të partisë politike nga e njëjta zonë zgjedhore (për shembull: personit zyrtar të partisë ose përfaqësuesit tjetër të partisë). Sido që të jetë, publiku duhet ta ketë të qartë se kandidati që nuk ka ardhur është ftuar në mënyrë të rregullt dhe duhet të tregohet shkaku se përse nuk ka mundur të marrë pjesë. Nëse partia nuk e dërgon përfaqësuesin e vet ose nominon ndonjë që do të kishte mundur që bashkëpjesë-

marrësit tjerë t'i vinte në situatë të pabarabartë, në atë rast emisioni mund të emetohet edhe pa atë përfaqësues. RTM do të përpiqet që t'i nxisë partitë që të delegojnë persona të rinj, me qëllim që të dëgjohen pikëpamje të ndryshme dhe me qëllim që më mirë të reflektohet llojllojshmëria e trupit zgjedhor. Nga ana tjetër, ndërkaq, kjo është e nevojshme me qëllim që të pamundësohet një personalitet i caktuar partiak të dominojë në programe, si për shembull, zëdhënësit e partive.

- ➔ Përveç gazetarëve dhe redaktorëve, edhe të gjithë personat tjerë të përfshirë në prodhimin e një programi - kameramanët, montazhistët, regjisorët, personat e ngarkuar për të bërë ndriçimin dhe zërimin etj., kanë obligim që të kujdesen që mos t'u japin përparësi jo fer disa kandidatëve në raport me të tjerët.
- ➔ Në lajme, intervista, debate dhe në lloje të tjera emisionesh udhëheqësi patjetër të sillet sipas parimeve etike dhe profesionale të paanshmërisë dhe të neutralitetit ndaj të gjithë pjesëmarrësve në emision. Ai/a jo nuk guxon të tregojë anim ndaj ndonjë opsioni politik/pjesëmarrës në çfarëdo qoftë mënyre (lloje të pyetjeve, gjestikulacion, intonim, shprehje të trupit, sjellje me mysafirët) dhe duhet t'u japë mundësi të gjithë pjesëmarrësve që t'i shprehin qëndrimet dhe mendimet e tyre.
- ➔ Kur kandidatët kanë role të tjera (politike ose jopolitike), duhet të mbahet llogari që ata të mos fitojnë përparësi të pabarabartë në fushatën zgjedhore, në krahasim me kandidatët tjerë.

### **3. Saktësi dhe kontrollim të informacioneve**

Parim kryesor në gazetari është që të gjitha informacionet në lajm (kontribut) të jenë tërësisht të sakta. Gazetari patjetër ta hulumtojë të vërtetën dhe ta tregojë në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse. Gazetari patjetër të ketë raport kritik ndaj informacioneve, çka nënkupton konfirmimin sistematik të të gjitha fakteve në kontribut.

Redaktorët dhe gazetarët patjetër ta kenë parasysh se besimi vështirë arrihet, por lehtë humbet.

***Që të konsiderohet i besueshëm, informacioni duhet t'i përmbushë kushtet në vazhdim:***

- Të jetë i vërtetë, jo i rremë. Manipulimet, dezinformatat dhe përhapja e thashethemeve janë praktikë e shpeshtë në periudhën zgjedhore. Gazetari asnjëherë nuk guxon të supozojë se informacioni është i vërtetë. Ai patjetër duhet të jetë i konfirmuar më së paku prej dy ose më shumë burimeve.
- Në rast dyshimi, më e përshtatshme është që informacioni të mos publikohet. Me qëllim që t'u iket spekulimeve dhe informacioneve të gabuara, RTM nuk do të publikojë informacione për ngjarje për të cilat nuk ka konfirmim zyrtar nga subjektet relevante.
- Gazetari gjatë shprehjes nuk duhet të përdorë konstrukcione gramatikore me të cilat mund të implikojë dyshim për aktivitete të ndonjë subjekti politik, përkatësisht kandidat, ose, ndërkaq, atë ta përqeshë.
- Çdo element i lajmit (kontributit gazetaresk) patjetër të jetë i saktë: ngjarjet, datat, vendet, citatat e të ngjashme. Një gabim për një fakt bazë mund t'i hedhë hije saktësisë së tërë kontributit.

→ Kur gazetari do të kuptojë (ose do të jetë i informuar) se ka informacion të pasaktë, patjetër e ka që shpejt ta korrigjojë dhe t'i japë rëndësi të njëjtë siç i ka dhënë në kontributin më parë.

Gazetarët duhet të citojnë burime sa është e mundur më shpesh. Kontributi për zgjedhje, i cili në tërësi mbështetet në burime anonime, do të konsiderohet i dyshimtë dhe i pasigurt. Për këtë shkak, metoda e këtillë gjithnjë duhet shmangur.

Gazetarët gjithnjë duhet ta pyesin burimin se përse ngul këmbë në anonimitet, sidomos kur bëhet fjalë për informacione që janë të ndjeshme ose për të cilat ka probabilitet se mund ta lëndojnë autoritetin e një personi, kandidati a partie. Gazetari me kujdes duhet t'i vlerësojë arsyet për anonimitet të burimit dhe, po qe se ato janë të arsyeshme (p.sh. frikë për sigurinë personale), atëherë informacionet mund të shfrytëzohen. Por, gazetari së pari duhet të marrë konfirmimin nga burimet e pavarura. RTM nuk guxon të lejojë që përmes burimit anonim të përhapë thashetheme ose akuza të pabaza.

Gazetarët e RTM-së patjetër të mbajnë llogari edhe për zgjedhjen e ekspertëve që do të shfrytëzohen si bashkëbisedues në kontribute/programe. Publiku mund të lajthitet nga zgjedhja e të ashtuquajturve “ekspertë të pavarur”. Gazetari duhet të jetë i kujdesshëm sidomos me “ekspertët” që janë të afërt me ndonjë opSION politik, kështu që duhet të konsultojë edhe bashkëbisedues të tjerë, të cilët kanë mendime alternative ose kundërshtuese.

Përgjithësisht, rekomandohet që në raportim të shmangjet fjala “ekspert”, e në vend të saj të bëhet përshtkrimi i punës së bashkëbiseduesit (profesor, blloger, gazetar, shkrimtar, historian etj.), përkatësisht të shpjegohet se përse ai/ajo ka kredibilitet që të flasë për një temë të caktuar.

#### **4. Informacionet duhet të jenë precize dhe në kontekst**

RTM do t'i mbulojë zgjedhjet në mënyrë të saktë dhe precize, e të gjitha informacionet do të vihen në kontekstin gjegjës dhe relevant.

***Duke e pasur parasysh këtë qëllim, gazetari domosdo duhet t'i ndjekë këto rregulla:***

- ➔ Kërkesa thelbësore të cilën duhet ta plotësojnë të gjitha kontributet/storjet është që ato të japin përgjigje në pyetjet në vazhdim: Kush? Çka? Kur? Ku? Si? dhe Pse?
- ➔ Gazetari patjetër të jetë preciz. Kur raportohet për miting, duhet të theksohet vendi, temat që përmenden në fjalime dhe reagimet e masës. Sidomos kur fjala është për radio, raportimi duhet të përmbledhë faktet - të informohet shkurt, qartë, thjesht dhe kuptueshëm.
- ➔ Nuk është i lejueshëm manipulimi i informacioneve përmes shfrytëzimit të kamerës, zërit, video- materialeve ose fotografive.
- ➔ Gazetarët duhet të kenë kujdes kur raportojnë për shifra/numra të paraqitur nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore. Numrat që kanë të bëjnë me të hollat, me projektet, me kilometrat e të ngjashme (rrugë, rrjet ujësjellësi, kanalizimi etj.), duhet të kontrollohen me kujdes pasi të jenë kumtuar nga politikanët. Po qe se bëhet fjalë për deklaratë të dhënë drejtpërdrejt ose për transmetim nga mitingu, ato gjithsesi se duhet të transmetohen, por nëse gazetari vëren ndonjë mungesë të logjikës ose të konsekuencës, do të duhet ta kontrollojë numrin dhe ta informojë publikun po qe se ai është i pavërtetë/jo i saktë.
- ➔ Gazetarët duhet t'i ikin vlerësimit për numrin e njerëzve që marrin pjesë në mitingje, në ngjarje e të ngjashme. Në vend të kësaj, kur bëhet fjalë për kontribut televiziv, rekomandohet

të paraqiten disa kuadro të gjera, që shikuesit vetë të nxjerrin konkluzionin për atë se sa ka qenë e vizituar një ngjarje e caktuar. Kur raportohet për radio, mjafton që gazetari ta theksojë vendin ku zhvillohet tubimi, që publiku të fitojë përshtypjen për masivitetin e saj (shesh, sallë sportive, pallat i kulturës, oborr i shkollës etj.).

- Jopreciziteti mund t'i "shtrembërojë" faktet. Gazetarët, redaktorët dhe kuadri teknik duhet të kenë kujdes gjatë zgjedhjes dhe gjatë shkurtimit të deklaratave të bashkëbiseduesve, të ruhet dhe të transmetohet në tërësi mendimi, përkatësisht thelbi i porosisë së bashkëbiseduesit. Për shembull, në një anketë kur qytetarët kanë qenë të pyetur se a u pëlqen një kandidat i caktuar për kryetar, njëri nga të intervistuarit është përgjigjur: "Është i mirë, por është plak." Gazetari e ka prerë pjesën e dytë të deklaratës, me ç'rast në kontribut është transmetuar vetëm: "Është i mirë." Kështu, për shkak të intervenimit të gazetarit, zgjedhësit janë vënë në lajthitje.
- Gabimet përherë janë të mundshme. Për këto shkaqe, gazetari që e mbulon tregimin duhet të ketë kujdes kur jep vlerësime për situatat ose për njerëzit dhe duhet t'i ikë gjykimit përfundimtar. Po qe se redaktori dhe gazetari e vërejnë gabimin, atëherë ai duhet të korrigjohet në lajmet e para të radhës.

## 5. Ndarja mes fakteve dhe mendimeve

Gazetarët vazhdimisht ballafaqohen me probleme gjatë raportimit për fakte dhe mendime, kështu që ata duhet ta dinë që t'i dallojnë njëra prej tjetrës. Kjo është me rëndësi, me qëllim të gjetjes dhe të përgatitjes së lajmeve.

**Faktin** mund ta definojmë si diçka që ka ndodhur ose për të cilin supozohet se është i vërtetë. Megjithatë, gazetarët duhet ta dinë se sa mund të mbështeten në deklaratat e caktuara para se ato t'i paraqesin si fakte para publikut. Ekzistojnë tri lloje faktesh me të cilat ballafaqohen gazetarët: faktet që janë dëshmuar si të vërteta; faktet që mbase janë të vërteta, edhe pse kjo nuk është dëshmuar; dhe faktet që do të mund të ishin të vërteta, edhe pse duken si gënjeshtër.

Mendimet dallojnë prej fakteve. **Mendimi** është konkluzion i ndokujt, i bërë mbi bazë të fakteve të vërejtura. Mendimet mbështeten mbi bazë të asaj që njerëzit konsiderojnë se janë fakte. Kjo mund të përfshijë fakte me probabilitet, bile edhe gënjeshtër, edhe pse një numër i vogël njerëzish në mënyrë të vetëdijshme do të kishin dhënë mendim që bazohet mbi gënjeshtërën e dëshmuar.

Për gazetarët ekzistojnë dy kategori kryesore të mendimeve: mendimet që janë të kontrollueshme/te të cilat mund të kontrollohet vërtetësia e tyre dhe mendime profesionale (eksperte). Kategoria e parë ka të bëjë me konkluzionet që mund të kontrollohen – të dëshmuara se janë të sakta ose të dëshmuara se janë konkluzione të gabuara.

Mendimi profesional (ekspert) është mendim për një çështje të caktuar me bazë në njohjen e veçantë të fakteve. Lloji më i mirë i mendimit profesional është ai kur bashkëbiseduesi ndjenjat personale i vë anash konkluzioneve. Bashkëbiseduesi që jep mendim profesional (ekspert), i prezanton faktet ashtu siç i sheh, dhe e nxjerr konkluzionin vetëm mbi bazë të fakteve. Megjithatë, madje

edhe mendimi i paraqitur nga “eksperti i paanshëm” patjetër t’i përshkruhet atij eksperti, me qëllim që publiku vetë të vlerësojë se sa është e saktë ajo çka ai e thotë.

Udhëheqësit dhe gazetarët nuk guxojnë t’i shprehin pikëpamjet dhe mendimet e tyre politike në lajme.

## **6. Roli i dyfishtë i pushtetit në periudhën zgjedhore**

Të jesh pjesë e pushtetit, do të thotë të jesh më shumë në vëmendjen e mediave për shkak të nevojës së mediave që t’i mbulojnë aktivitetet e pushtetit, që mund të përfshijë ngjarje zyrtare, takime dhe politika që zbatohen. Ngjarjet mund të jenë *të vërteta dhe relevante* (si festime nacionale, ose përvjetorë), *të vërteta dhe marginale* (si hapje të objekteve publike) dhe *pseudo-ngjarje* (ngjarje me kreacion ose menaxhim nga ana e qeverisë, me qëllim që të tërheqë mbulim më të madh medial).

Përfaqësuesit e pushtetit në fushatë kanë rol të dyfishtë - si përfaqësues të pushtetit, por edhe si kandidatë të zgjedhjeve në vazhdim nga partia politike që është në pushtet. Ky identitet i dyfishtë është problematik nga dy aspekte:

- E drejta e qasjes së njëjtë për të gjithë kandidatët, që duhet të jetë e balancuar me lirinë dhe obligimin e mediave që t’i mbulojnë aktivitetet e pushtetit;
- E drejta e trajtimit të njëjtë të të gjithë kandidatëve. Lajmet e lidhura me partinë në pushtet, ndonjëherë mund të vihen në kornizë në mënyrë pozitive për shkak të ngjarjes që mbulohet, sikurse që janë: takimet zyrtare, samitet ndërkombëtare ose të ngjashme.

Përfaqësuesit e pushtetit mund të përpiqen që aktivitetet që lidhen me fushatën zgjedhore t'i fshehin ose t'i vënë në kornizat e aktiviteteve të tyre institucionale, siç është hapja e ndërtesave, fjalime para studentëve, hapja e programeve për të varurit nga droga e të ngjashme. Për këtë shkak, gazetarët duhet të bëjnë përpjekje që t'i ndajnë qartë këto aktivitete dhe të mos u japin trajtim të privilegjuar pjesëtarëve të pushtetit. Kjo është e rëndësishme sidomos në kontekst të përpjekjeve që të sigurohet autonomia dhe pavarësia nga qendrat e fuqive politike dhe ekonomike.

## 7. Gjuha e urrejtjes dhe gjuha “ndezëse”

Në kuadër të fushatës zgjedhore, njëra prej sfidave më të mëdha profesionale për gazetarët është çështja se si të raportojnë për gjuhën “ndezëse” dhe për deklarata të cilat nxisin ose mund të nxisin urrejtje ose mosdurim mbi baza të ndryshme. Obligimi për përgjegjësinë shoqërore të gazetarit, prej tij kërkon që ta marrë parasysh rrethimin politik në tërësi.

Në situata shoqërore-politike ekstremisht jostabile, ku raportohet për gjuhën e urrejtjes, me të cilën do të kishte mundur që të kërcënohen individë, bashkësi ose kombe të tëra, njëra prej mënyrave të veprimit moral të gazetarit është të përmbahet nga raportimi për komente të tilla.

Nga ana tjetër, raportimi me kujdes dhe korrekt për gjuhën e shprehur të urrejtjes, është metodë e leverdishme për paralajmërim të hershëm, me të cilin do të kallëzohet se ka mundësi për konflikt shoqëror serioz ose për shkelje të të drejtave të njeriut në kuadër të fushatës. Për këtë shkak, media ka obligim që me kujdes të transmetojë gjuhën e urrejtjes, komentet dhe aktivitetet ndezëse të partive dhe të kandidatëve, por me këtë rast t'i dënojë dhe t'i shpërfytyrojë ato, duke e vënë kështu në pyetje kredibilitetin e tyre.

Në rrethana të caktuara, raportimi i saktë për gjuhën nderëse, ose për gjuhën e urrejtjes, mund të shërbejë për shkatërrimin e qëllimeve të burimeve, në këtë rast të partive ose të kandidatëve. Gazetarët do të duhej që t'i dokumentonin pasojat e fjalëve dhe të aktiviteteve të këtilla. Për shembull, po qe se njerëz nga publiku e braktisin mitingun politik ose, ndërkaq, sillen në mënyrë të dhunshme kundër kundërshtarëve ose mbështetësve, ky është moment i rëndësishëm për të cilin patjetër të raportohet.

Po qe se në emisionin që shkon drejtpërdrejt ndonjë pjesëmarrës përdor gjuhën e urrejtjes, udhëheqësi menjëherë do ta ndërpresë, do të distancohet nga ajo gjuhë, dhe do ta paralajmërojë bashkëbiseduesin se më nuk do t'i jepet fjala po qe se vazhdon me një gjuhë të tillë. Gazetari do ta ndërpresë dhe do ta përjashtojë nga programi edhe bashkëbiseduesin i cili në një emision kontakti përdor gjuhën e urrejtjes ose gjuhën “nderëse”.

## **8. Informimi për hulumtimin e mendimit publik**

Raportimi për rezultate nga hulumtimi i mendimit publik në periudhën zgjedhore është i rëndësishëm, për shkak se ato janë pjesë e tregimit gjatë kohës së procesit zgjedhor dhe publiku ka të drejtë të dijë për to. Me këtë rast, me rëndësi thelbësore është që gazetari të mbajë llogari për kontekstin e raportimit për rezultatet e hulumtimeve, për saktësinë e informacioneve dhe për përkatësinë e gjuhës që shfrytëzohet. Gazetari, gjithashtu, duhet të ketë parasysh se rezultatet mund të jenë të gabuara, për të cilën gjë ka rrezik real që publiku të mashtrohet po qe se raportohet vetëm për hulumtime të mendimit publik që tregojnë ose sugjerojnë lëvizje ose ndryshime dramatike. Për këtë shkak, RTM do të raportojë për rezultate nga hulumtimi i mendimit publik vetëm nëse është i njohur porositi i hulumtimit dhe nëse ai është realizuar sipas ekzemplarit reprezentativ.

***Gjatë publikimit të rezultateve nga hulumtimi i mendimit publik RTM do t'i respektojë këto parime:***

- Detyrimisht do t'i publikojë këto të dhëna: emrin e porositësit që ka kërkuar dhe e ka paguar hulumtimin, emrin e institucionit që e ka kryer hulumtimin, metodologjinë e zbatuar, madhësinë dhe strukturën e ekzemplarit të hulumtuar dhe periudhën gjatë së cilës është bërë hulumtimi;
- Nuk do t'i organizojë lajmet rreth rezultateve të një hulumtimi të vetëm të mendimit publik;
- Në titrin ku qëndron titulli i kontributit nuk do të potencohen rezultatet nga hulumtimi që shkon në favor ose kundër ndonjë opsioni politik;
- Nuk do të mbështetet vetëm në interpretimin e rezultateve nga hulumtimi i dhënë nga ana e subjektit që e ka porositur, ose që e ka realizuar hulumtimin, por gazetari vetë do të përpiqet që të formojë qëndrim duke i analizuar çështjet, rezultatet dhe trendët;
- Me kujdes të veçantë do t'i trajtojë rezultatet nga hulumtimi që shkojnë në kundërshtim me trendët më parë të përcaktuara për disponimin e votuesve pa shpjegimin bindës për shkaqet;
- Nuk do të shfrytëzojë gjuhë e cila i jep kredibilitet më të madh hulumtimit nga ajo çfarë ai e meriton.

## **9. Heshtja zgjedhore**

Gjatë heshtjes zgjedhore, RTM do të vazhdojë të raportojë për procesin zgjedhor dhe për rrjedhën e votimit, me ç'rast nuk do të emetojë përmbajtje të cilat do të kishin mundur të konsiderohen thyerje të heshtjes zgjedhore, të cilat janë të përcaktuara në Rregullat për mbulimin medial të proceseve zgjedhore.

## **10. E drejta e korrigjimit dhe e përgjigjes**

Cilido pjesëmarrës në procesin zgjedhor (kandidat, parti politike, koalicion etj.), si dhe çdo person fizik ose juridik, ka të drejtë që nga RTM, përkatësisht nga redaktori përgjegjës i RTM-së, të kërkojë publikimin e korrigjimit në lajmin e publikuar, ku theksohen informacione të pasakta, me të cilat do të ishin shkelur të drejtat ose interesat e tij, ose, ndërkaq, mund të kërkojë përgjigje për informacionin e publikuar po që se ka mosmarrëveshje në lidhje me faktet e publikuara, ose ka interes legjitim që kjo të bëhet.

Korrigjimi patjetër të publikohet pa ndryshime, pa plotësime a komente të redaksisë, në afat mundësisht sa më të shpejtë.



## II.

# PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE DHE INTEGRITETI PERSONAL I GAZETARËVE

### 1. Përgjegjësia shoqërore e gazetarëve

Liria e mediave kërkon përgjegjësi. Gazetari në të njëjtën kohë është edhe qytetar dhe ai, qoftë edhe kur e kryen profesionin, mund të ketë rol në zgjidhjen e krizave politike dhe të konflikteve. Gazetari gjithnjë duhet të jetë i vetëdijshëm për ndikimet e mundshme pozitive dhe negative nga puna e tij. Kjo do të thotë se pa marrë parasysh temën, fjalët dhe toni i tij patjetër të jenë sa është e mundur më neutralë dhe më të kthjellët. Kjo, gjithashtu, nënkupton edhe arsyeshmërinë kur raportohet për tema që kanë potencial të nxisin incidente ose konflikte, si dhe njollosje a etiketim të individëve ose grupeve.

#### ***Duke i pasur parasysh këta faktorë, gazetari duhet:***

- Të respektojë dinjitetin njerëzor dhe prezumimin e pafajësisë. Ai patjetër t'i shmangët "hedhjes" së dyshimeve ndaj autoritetit dhe nderit të ndokujt, pa pasur me këtë rast informacione të besueshme.
- Të respektojë jetën private dhe informacionet private dhe t'i shmangët raportimit në lidhje me to, përveç kur kjo me të

vërtetë është e domosdoshme për ta kuptuar ndonjë ndodhi a situatë në jetën publike.

- Të refuzojë të nxisë ose të përhapë thashetheme, qoftë edhe nëse mediat tjera këtë e bëjnë.
- Të përmbahet nga çfarëdo diskursi që nxit urrejtje, dhunë, rrënim, vjedhje, jotolerancë, racizëm, ksenofobi dhe paragjykitime. Gazetarët që nuk i respektojnë këto rregulla, rrezikojnë të ballafaqohen me dënime ligjore.

## 2. Integriteti dhe ndershmëria profesionale e gazetarëve

Gazetari duhet ta dijë se si duhet të mbetet i pavarur nga partitë dhe nga kandidatët. Që ta ruajë qasjen tek ata, është e nevojshme që të ketë ndjesinë për karakterin e tyre dhe t'i kuptojë qëllimet e tyre politike. Raportet me politikanët duhet të jenë rreptësisht profesionale, pa qëllime për lidhjen e miqësive.

***Për këto shkaqe, gazetari kurrë nuk guxon:***

- Të pranojë të holla, dhurata të çfarëdo lloj vlere, ose çfarëdo lloj shërbimi, që do të kishin mundur të ndikonin ndaj mendimit të tij, do të kishin krijuar konflikt të interesit, ose do ta kishin dëmtuar integritetin dhe dinjitetin e tij profesional.
- Të pranojë çfarëdo shërbimi në shkëmbim të publikimit ose të mospublikimit të ndonjë kontributi.

**Konflikti i interesit** mund të ndodhë kur aktivitetet e jashtme të secilit që është i përfshirë në krijimin e përmbajtjeve (gazetar, redaktor, kuadër teknik, frilenser, gazetar-hulumtues, producent...) ndikojnë ndaj autoritetit, integritetit, paanshmërisë dhe pavarësisë së RTVM-së. Publiku patjetër t'i besojë RTVM-së dhe të jetë i sigurt

se interesat e jashtme, presionet politike a komerciale, ose çfarëdo interesi personal, nuk ndikon ndaj vendimeve redaktuese. Kjo sidomos ka të bëjë me ata punonjës të medias që i përgatisin lajmet dhe programet informative.

#### ***Udhëheqësit dhe gazetarët në lajme nuk guxojnë:***

- Të bëjnë promovime ose reklama për cilëndo kompani, organizatë të jashtme a parti politike (përjashtim janë aktivitetet promovuese për librat që më parë i kanë shkruar).
- Nuk guxojnë që publikisht të tregojnë se si kanë votuar, ose të shprehin mbështetjen për ndonjërin prej partive.
- Të shprehin mendim për ose kundër, ose të bëjnë lobim për ndonjë temë/politikë publike/tema politike ose të biznesit/tema kontroverze, e sidomos kur ato janë pjesë e debatit politik aktual.

#### ***Gazetarët patjetër e kanë që me nder ta kryejnë punën e tyre. Ruajtja e këtij obligimi në raportimin medial do të thotë:***

- Gazetari nuk guxon të shfrytëzojë mjete joadekuate për marrjen e informacioneve (për shembull: incizim të bisedës me kandidatin pa marrë lejen më parë).
- Gazetari nuk guxon të harxhojë ose të pranojë të holla në shkëmbim të informacioneve.
- Gazetari e ka patjetër që t'u tregojë njerëzve të cilët nuk janë të njohur me këtë se si funksionojnë mediat, se ajo çka ata do ta deklarojnë mund të përfshihet në raportin gazetaresk të cilin do ta shikojnë ose do ta dëgjojnë shumë njerëz.
- Gazetari nuk e bën për vete veprën e huaj dhe mban llogari se e citon punën e kolegëve kur e shfrytëzon produktin e punës së tyre. Me këtë rast e tregon burimin e tekstit/të zërit/videos/fotografisë që i shfrytëzon në punën e tij, e të cilat vijnë

prej dikujt tjetër. Kështu, për shembull, kur citohen intervista ose tekste nga media të tjera, gazetari patjetër e ka që në mënyrë të qartë të informojë se nga cila media janë pjesët e marra.

### **3. Përdorimi personal i mediave sociale**

Të gjithë ata që prodhojnë ndonjë përmbajtje në RTM (gazetarë, redaktorë, kuadër teknik, frilenserë, gazetarë-hulumtues, producentë...) patjetër të jenë të vetëdijshëm se shfrytëzimi i çfarëdo simboleve partiake në *Facebook* dhe në *Twitter* paraqet një lloj informimi. Për këtë shkak, redaktorët, gazetarët dhe të gjithë të tjerët që janë të përfshirë në krijimin e përmbajtjeve në lidhje me zgjedhjet, patjetër të mbajnë llogari që mos ta propozin paanshmërinë e RTM-së, ose ta rrënojnë autoritetin e RTM-së, përmes aktiviteteve të tyre në rrjetet sociale, qoftë edhe në cilësinë private.

Prandaj, nuk është e rekomandueshme paraqitja e mendimeve personale për çështje politike, qoftë në faqet personale të internetit, qoftë në mediat sociale. Ky rekomandim ka të bëjë me tekstet, fotografitë, videot, logot, bexhet ose çfarëdo lloj materiali tjetër që mund të asociojë në një parti të caktuar politike.

### III.

## KONTRIBUTI NGA PUBLIKU DHE PJESË-MARRËSIT NË ZGJEDHJE

### 1. Materiale nga publiku

Mundësimi i komunikimit dhe i interaktivitetit me publikun përmes platformave dhe mekanizmave të ndryshëm është me rëndësi të veçantë për zhvillimin e besimit tek servisi publik. RTM duhet të mbajë raport të sigurtë dhe të hapur me publikun, i cili nuk guxon të vihet në lajthitje.

Publiku mund të kontribuojë në krijimin e programeve të RTM-së në mënyra të ndryshme: përmes paraqitjeve me telefon, porosive SMS, porosive në mediat sociale (*Facebook, Twitter* ose *YouTube*), përmes postës elektronike, ose përmes mekanizmave të tjerë interaktivë, përfshi edhe “vox pop”. Producentët e përmbajtjeve duhet të jenë të kujdesshëm në përcaktimin e prejardhjes së materialit që është marrë nga publiku dhe të marrin mbi vete përgjegjësinë për kontrollimin e autenticitetit të tij.

RTM duhet ta përshkruajë raportin real edhe të mendimeve të publikut (për shembull, nëse 60% nga komentet janë pro-qeveritare, ndërsa 40% janë pro-opozitare, ose e kundërta, ky raport në rrjetet sociale duhet të përshkruhet).

RTM nuk guxon t'i trajtojë këto informacione si burim të sigurt, por patjetër e ka të jetë i hapur për bashkëpunim me publikun. Të gjitha informacionet që merren nga publiku patjetër të kontrollohen dhe të konfirmohen para se të publikohen. Në situatat kur qytetarët japin informacione relevante, të cilat do të ishin me interes edhe për publikun më të gjerë (siç janë mashtrimet zgjedhore ose incidentet), gazetarët patjetër ta kontrollojnë materialin në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të presin konfirmimin e informacioneve, para se të njëjtat t'i publikojnë. Gazetari mund të dalë në terren dhe të përpiqet që vetë t'i kontrollojë informacionet.

Gazetarët nuk duhet që me automatizëm të supozojnë se informacionet që vijnë nga rrethet akademike, gazetarë, hulumtime, përfaqësues të organizatave bamirëse e të ngjashme, janë të paanshme dhe duhet t'i dëftojnë opinionit publik po qe se burimet janë të lidhura me ndonjë pikëpamje të caktuar.

Të gjithë që krijojnë përmbajtje duhet të sigurojnë se burimet e informacioneve janë të përshkruara në mënyrë adekuate dhe se i kanë marrë parasysht informacionet relevante të cilat do të kishin dëftuar anshmërinë ose joobjektivitetin e mundshëm.

## **2. Materiale nga partitë ose nga kandidatët**

Partitë politike i incizojnë ngjarjet e tyre (mitingjet e të ngjashme) dhe mund t'u ofrojnë material të gatshëm gazetarëve. Megjithatë, materiali i këtillë edhe më tej përmban rrezikun për manipulime eventuale me përshtypjet e opinionit publik, si p.sh. në lidhje me shkallën e vizitës së ngjarjes, çka është thënë ose çka është lëshuar prej saj, duartrokitjet, vënia e theksit te lideri ose tek simbolet e caktuara etj.

Prandaj, po qe se RTVM në ndonjë ngjarje nuk ka ekipin e vet për shkaqe logjistike, mund të kërkojë incizim nga ndonjë burim tjetër, ashtu që në mënyrë të qartë do të shënohet prejardhja e atij inci-

zimi. Kjo mund të jetë edhe incizim nga partia, por patjetër duhet të theksohet se prej nga e ka prejardhjen (sidomos kur bëhet fjalë për ndonjë ngjarje shumë të rëndësishme, incident ose të ngjashme...). Çfarëdo kontributi nga kandidatët partiakë, patjetër të shënohet në mënyrë të qartë.

Gjatë shfrytëzimit të materialeve të këtilla, në informacion duhet përdorur gjuha neutrale, përkatësisht gazetari duhet të tregojë se cili është burimi i informacionit (p.sh.: na dëftuan, na drejtuan, siç na informuan, u tha nga ana e kësaj partie etj.).

*Këto parime u përgatitën nga ana e grupit të punës, i përbërë nga profesionistë të medias:*

*Dushko Arsovski, Radiotelevizioni Maqedonas*

*Biljana Trendafilova, Radiotelevizioni Maqedonas*

*Merita Gashi, Radiotelevizioni Maqedonas*

*Marina Tuneva, Këshilli për Etikë në Media i Maqedonisë*

*Emilija Janevska, Agjencia për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizive*

*Vesna Nikodinoska, Instituti Maqedonas për Media*

*Zoran Tanevski, më parë gazetar dhe zëdhënës i mëparshëm i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve*

**Grupi i punës, përmes trajnimeve dhe konsultimeve, u mbështet nga BBC Media Action.**

Ky dokument përmban standarde relevante profesionale dhe etike ndërkombëtare dhe të vendit, të përcaktuara në këto udhëzime dhe publikime:

- *Kahe të BBC-së për mbulimin e zgjedhjeve*, BBC, 2015. E arritshme në: [http://downloads.bbc.co.uk/guidelines/editorialguidelines/pdfs/2015\\_Election\\_Guidelines.pdf](http://downloads.bbc.co.uk/guidelines/editorialguidelines/pdfs/2015_Election_Guidelines.pdf).
- *Kahe redaktuese të BBC-së*, BBC. E arritshme në: <http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/guidelines>.
- *Doracak për gazetarë gjatë kohës së zgjedhjeve*, Reporterë pa Kufij dhe Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë. E arritshme në: [https://en.rsf.org/IMG/pdf/handbook\\_for\\_journalists\\_during\\_elections\\_.pdf](https://en.rsf.org/IMG/pdf/handbook_for_journalists_during_elections_.pdf).
- *Kahe për raportim për zgjedhje*, ARTIKULLI 19, 1994, ribotuar 1997. E arritshme në: <https://www.article19.org/data/files/pdfs/tools/electionbroadcastingtrans.pdf>.
- *Raportim për zgjedhje – kahe për radiopërhapësit*, ARTIKULLI 19, Indeksi i Lirisë së Shprehjes, Rojters dhe UNESKO. E arritshme në: [http://webworld.unesco.org/download/fed/iraq/english/broadcast\\_guidelines\\_en.pdf](http://webworld.unesco.org/download/fed/iraq/english/broadcast_guidelines_en.pdf)
- *Насоки за медиумска анализа за време на мисиите на ОБСЕ за набљудување на избори*, OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias, 2009.

## Literatura e shfrytëzuar

*Kahe të BBC-së për mbulimin e zgjedhjeve*, BBC, 2015. E arritshme në: [http://downloads.bbc.co.uk/guidelines/editorialguidelines/pdfs/2015\\_Election\\_Guidelines.pdf](http://downloads.bbc.co.uk/guidelines/editorialguidelines/pdfs/2015_Election_Guidelines.pdf).

*Kahe redaktuese të BBC-së*, BBC. E arritshme në: <http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/guidelines>.

*Doracak për gazetarë gjatë kohës së zgjedhjeve*, Reporterë pa Kufij dhe Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë. E arritshme në: [https://en.rsf.org/IMG/pdf/handbook\\_for\\_journalists\\_during\\_elections\\_.pdf](https://en.rsf.org/IMG/pdf/handbook_for_journalists_during_elections_.pdf).

*Kahe për raportim për zgjedhje*, ARTIKULLI 19, 1994, ribotuar 1997. E arritshme në: <https://www.article19.org/data/files/pdfs/tools/electionbroadcastingtrans.pdf>.

*Raportim për zgjedhje – kahe për radiopërhapësit*, ARTIKULLI 19, Indeksi i Lirisë së Shprehjes, Rojters dhe UNESCO. E arritshme në: [http://webworld.unesco.org/download/fed/iraq/english/broadcast\\_guidelines\\_en.pdf](http://webworld.unesco.org/download/fed/iraq/english/broadcast_guidelines_en.pdf).

*Насоки за медиумска анализа за време на мисиите на ОБСЕ за набљудување на избори*, OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias, 2009.

Ueb-faqja Media Helping Media, Resurse për trajnime mediale. E arritshme në: [www.mediahelpingmedia.org](http://www.mediahelpingmedia.org).

*Ligji për shërbime mediale audio dhe audiovizive i Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e RM nr. 184/2013, 13/2014, 44/2014, 101/2014 dhe 132/2014.

*Kodi zgjedhor i Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e RM. 32/2014, 196/2015.

*Kodi i gazetarëve të Maqedonisë*, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, 2001. E arritshme në: <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/440>.

Përkthimi dhe redaktimi gjuhësor: Nazif Zejnullahu

